FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

CINARIZINE

Tableta - 25 mg ose 75 mg
(Cinarizinë)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.
- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

1. Çfarë është Cinarizine dhe përse përdoret
2. Përpara se të merrni Cinarizine
3. Si ta merrni Cinarizine
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Cinarizine
6. Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË CINARIZINE DHE PËRSE PËRDORET

Cinarizina është antagoniste e receptorëve H1 dhe kalçiblokuese. Cinarizina frenon bartjen e joneve të kalçiumit në qelizat e muskulaturës së lëmuar të arterieve dhe shkakton vazodilatacion. Cinarizina është një qetësuese e efektshme e labirintit. Ajo ka veprimtari antivazokonstriktive e prandaj përdoret për të përmirësuar simptomat e shkaktuara nga perfuzionimi i dobët trunor dhe periferik. Cinarizina nuk ndikon në presionin e gjakut dhe ritmin e zemrës.
Cinarizine tableta indikohet në:
- simptoma të arterosklerozës cerebrale (marrje mendsh, zhurmë në vesh, dhimbje koke vaskulare, çrregullim i kujtesës);
- pasojat nga traumat e kokës;
- pasojat nga aksidentet cerebrovaskulare;
- migrenë;
- çrregullime vaskulare periferike (arterit obliterant, sëmundje e Buergerit, sëmundje Raynaud, diabet, akrocianozë, morth);
- mjekimin e të përzierave dhe vertigos që shkaktohen nga sëmundja e Menierit dhe të çrregullimeve të tjera të labirintit;
- parandalimin e sëmundjes së lëvizjes (udhëtim me automjet, anije, avion).

2. PËRPARA SE TË MERRNI CINARIZINE

Mos merrni Cinarizine në qoftë se:
- jeni i ndjeshëm (alergjik) ndaj cinarizinës apo ndonjërit prej përbërësve të tjerë të Cinarizine;
- vuani nga Parkinsoni;
- keni çrregullime në sistemin motor ekstrapiramidal;
- keni infarkt akut të miokardit;
- vuani nga porfiria.

Tregoni kujdes të veçantë me Cinarizine
Pyesni mjekun tuaj përpara se të merrni Cinarizine në qoftë se:
- jeni shtatzënë ose po planifikoni të ngeleni shtatzënë, sepse nuk duhet përdorur gjatë shtatzënisë, sidomos gjatë tremujorit të parë;
- jeni të sëmurë me glaukomë;
- jeni të sëmurë me hipertrofi të prostatës, keni bllokim piloro – duodenal, keni mbajtje të urinës;
- vuani nga sëmundje të mëlçisë;
- keni dëmtim të funksionit të veshkave;
- vuani nga epilepsia (dozat e larta mund të nxisin kriza në epileptikët);
- vuani nga hipotensioni sepse Cinarizine nuk rekomandohet në këto raste;
- do të përdoret në kurimin e një fëmije, sepse në këto raste duhet përdorur vetëm në periudha të shkurtra.

Marrja e barnave të tjera
Trajtimi i njëkohshëm me barna të tjera mund të ndikojë ose të ndikohet nga Cinarizine.
Ju lutemi të kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë ose keni marrë kohët e fundit barna të tjera, përfshirë ato të marra pa recetë. Mos harroni të informoni mjekun tuaj për trajtimin me Cinarizine në qoftë se ju jepet ndonjë bar tjetër gjatë trajtimit.
Është veçanërisht e rëndësishme që mjeku juaj të jetë në dijeni të faktit që ju jeni duke përdorur ose duke u trajtuar me:
- qetësues të SNQ, antidepresivë triciklikë, analgjezikë opioidë (cinarizina mund ta rrisë efektin e tyre qetësues);
- vazodilatatorë dhe antihipertensivë të tjerë (sepse cinarizina vepron në mënyrë sinergjiste kur kombinohet me ta);
- antiemetikë, domperidon (po ashtu, cinarizina vepron në mënyrë sinergjiste me të).

Për shkak të efekteve të saj antihistaminike, cinarizina mund të fshehë një reaksion pozitiv të indikatorëve dermalë. Si e tillë cinarizina këshillohet të ndërpritet disa ditë para provës së lëkurës.

Marrja e Cinarizine me ushqim dhe pije
Cinarizina fuqizon efektin qetësues të alkoolit, kjo është arsyeja që tabletat Cinarizine nuk duhet të përdoren në të njëjtën kohë me alkool.

Shtatzënia dhe Ushqimi me gji
Kërkoni këshillën e farmacistit ose të mjekut përpara se të merrni këtë bar.
Këshillohet mënjanimi i përdorimit të cinarizinës gjatë shtatzënisë. Cinarizine nuk duhet të përdoret gjatë shtatzënisë, sidomos gjatë tremujorit të parë, prandaj konsultohuni gjithmonë me mjekun tuaj përpara se të përdorni Cinarizine gjatë shtatzënisë.
Përdorimi i cinarizinës nuk rekomandohet gjatë ushqimit me gji.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive
Tregohuni të kujdesshëm gjatë drejtimit të automjetit ose përdorimit të makinerive derisa të shihni se si Cinarizine ndikon tek ju. Cinarizine mund t'i ulë aftësitë tuaja për të drejtuar automjetin ose për të punuar me makineri në sajë të efekteve anësore që shoqërojnë administrimin e saj, si përgjumja dhe turbullimi i të parit.

Informacione të rëndësishme për disa nga përbërësit e Cinarizine
Tabletat Cinarizine përmbajnë laktozë. Nëse ju është thënë nga mjeku juaj që keni intolerancë nga disa sheqerna, kontaktoni mjekun tuaj përpara se t'i merrni ato.

3. SI TA MERRNI CINARIZINE

Gjithmonë merreni Cinarizine sipas këshillës së mjekut. Në qoftë se nuk jeni i sigurt, kontaktoni me mjekun ose farmacistin. Në qoftë se ndjeni që efektet e Cinarizine janë shumë të forta ose shumë të dobëta, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj.
Tabletat duhet të gëlltiten me të paktën gjysmë gote ujë.
Dozimi i cinarizinës është individual. Më poshtë jepet një pasqyrë praktike për dozimin e saj:
Në çrregullime vestibulare: 75 mg, 1 - 2 herë në ditë.
Në çrregullime të qarkullimit okular: 75 mg, 2 - 3 herë në ditë.
Në çrregullime vaskulare periferike: 75 mg, 2 - 3 herë në ditë.
Në parandalimin e sëmundjes së lëvizjes:
Të rriturit dhe fëmijët mbi 12 vjeç: 25 mg, 2 orë para fillimit të udhëtimit.
Fëmijët 5 – 12 vjeç: gjysma e dozës që përdoret për të rriturit.
Doza maksimale ditore është 225 mg. Megjithatë, doza mund të ketë nevojë për tu rritur ose për tu ulur. Mjeku juaj do t'ju këshillojë në përputhje me rrethanat.

Në qoftë se keni marrë më shumë Cinarizine
Në qoftë se keni marrë më shumë Cinarizine se sasia që duhet të merrnit, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin, ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.

Në qoftë se harroni të merrni Cinarizine
Në qoftë se harroni një dozë (ose më shumë doza), merrni dozën në vazhdim kur të jetë koha për marrjen e zakonshme të saj.
Mos merrni një dozë të dyfishtë (ose më të lartë) për të plotësuar dozën (dozat) e harruar(a).
Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Si të gjitha barnat e tjera, Cinarizine mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston. Ndonjëherë ato janë serioze, ndonjëherë jo. Mos u alarmoni nga kjo listë e efekteve të mundshme anësore. Mund të mos ju shfaqet asnjë prej tyre.
Disa nga efektet anësore që mund të shfaqen janë:
- në fillim të mjekimit me cinarizinë mund të shfaqet përgjumje;
- çrregullime gastrointestinale (të përziera, të vjella, tharje e gojës, diarre dhe dhimbje epigastrike), anoreksi;
- dhimbje koke, shtim në peshë;
- turbullim i të parit, mbajtje e urinës;
- reaksione alergjike;
- konfuzion, konvulsione, depresion, marrje mendsh, efekte ekstrapiramidale, çrregullime të gjumit, dridhje, djersitje, hipotension;
- simptoma nxitjeje (eksitim paradoksal);
- aritmi; çrregullime të gjakut;
- mjekimi afatgjatë mund të shkaktojë parkinsonizëm (në raste të tilla mjekimi duhet ndërprerë).

Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore përkeqësohet, ose në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk përmenden në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të lajmëroni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI CINARIZINE

Mbajeni larg fëmijëve.
Mos e përdorni Cinarizine pas datës së skadimit e cila është e shënuar në paketim.
Mos e ruani mbi 25°C.
Ruajeni në paketimin origjinal për ta mbrojtur nga drita dhe lagështia.

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmban Cinarizine - Tableta 25 mg
Lënda vepruese është cinarizinë.
Çdo tabletë përmban 25 mg cinarizinë.
Përbërësit e tjerë: laktozë, celulozë mikrokristalore, talk, stearat magnezi dhe glikolat natriumi i amidonit.
Përmbajtja e paketimit
Kuti me 30 tableta dhe kuti me 50 tableta.

Çfarë përmban Cinarizine - Tableta 75 mg
Lënda vepruese është cinarizinë.
Çdo tabletë përmban 75 mg cinarizinë.
Përbërësit e tjerë: amidon, laktozë, celulozë mikrokristalore, stearat magnezi, povidon, talk dhe glikolat natriumi i amidonit.
Përmbajtja e paketimit
Kuti me 50 tableta.

Shpjegues i ikonave ilustruese për paketim:

Sipas recetës së mjekut.

Kujdes gjatë shtatzënisë.

Përmbajtja. Kujdes.

Forma e tabletës.

Mbajtësi i autorizimit për tregtim (MAT) dhe prodhuesi:

PROFARMA Sh.a.
Rruga "Myslym Keta"
Tel.: 00355 4 23 89 602
Tiranë - SHQIPËRI

Ky fletëudhëzues u rishikua për herë të fundit në Prill 2015.

SPECIFICATION

CROPING AREA 12 x 19 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible.
If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.